



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 prill 2019
Nr. ref.:RK1349/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI30/19

Parashtrues

Isni Kryeziu

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Rregullores (QRK) nr. 14/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të 26 shatorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Isni Kryeziu, me vendbanim në fshatin Bubavec, komuna e Malishevës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Akti i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Rregulloren (QRK) nr. 14/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të 26 shtatorit 2018 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja nr. 14/2018)

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar, me të cilin parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).
4. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht shtyrjen e ekzekutimit të Rregullores nr. 14/2018 deri në marrjen e vendimit nga Gjykata.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e Përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), si dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 21 shkurt 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 4 mars 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 8 mars 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (në tekstin e mëtejshëm: MASHT) për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 3 prill 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës nga viti 2007 ka ushtruar pozitën e Drejtorit të Departamentit Ligjor në MASHT.
11. Më 11 shtator 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria), përmes Vendimit nr. 1/64, miratoi Rregulloren nr. 14/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MASHT, e cila u nënshkrua nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, më 26 shtator 2018, dhe u publikua në Gazetën Zyrtare më 28 shtator 2018.
12. Më 23 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dhe disa persona të tjerë, parashtruan padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër Qeverisë së Kosovës – MASHT-it, duke kërkuar shfuqizimin e Rregullores nr. 14/2018.
13. Më 26 tetor 2018, Gjykata Themelore nxori Aktvendim [A. nr. 2526/18] me të cilin hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës dhe disa personave të tjerë si të palejueshme, me arsyetimin se *“konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet kundër akteve që përmbajnë një detyrim të përgjithshëm të nxjerrë nga organet administrative përderisa me zbatimin e aktit të kontestuar nuk kemi ende cenim të të drejtave të ligjshme të palëve”*.
14. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktvendimit [A. nr. 2526/18] të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës dhe disa persona të tjerë paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit.
15. Më 21 nëntor 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [AA. nr. 544/2018], e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe disa personave të tjerë dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, duke arsyetuar se paditësit në asnjë fazë të procedurës nuk kanë ofruar dëshmi që kanë vepruar në baza ligjore sipas dispozitave të Ligjit për Konflikte Administrative për fillimin e procedurës gjyqësore të konfliktit administrativ, përkatësisht se i kanë shterur mjetet juridike ashtu si parashihet me dispozitat e Ligjit të Procedurës Administrative në procedurë administrative, andaj, me të drejtë Gjykata Themelore, meqë paditësi nuk konteston ligjshmërinë e asnjë vendimi administrativ përfundimtar, e hedhë poshtë padinë si të palejuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Rregullorja nr. 14/2018 shkelë të drejtat e tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.
17. Parashtruesi ankohet se Rregullorja nr. 14/2008, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, konkretisht Ligjin për Shërbimin Civil, Ligjin për Administratën Shtetërore, Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rregulloren nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, Rregulloren nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit

Publik, duke cituar edhe dispozita konkrete të këtyre ligjeve dhe akteve nënligjore.

18. Parashtruesi i kërkesës thekson se në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore të cekura më lart, përmes Rregullores nr. 14/2018, shuhet Departamenti Ligjor në MASHT dhe fuzionohen disa departamente të tjera dhe me këtë rast cenohen të drejtat nga marrëdhënia e punës së parashtruesit të kërkesës si Drejtor i Departamentit Ligjor në MASHT.
19. Gjithashtu, ai pretendon se në *“Katalogun e Vendeve të Punës, të miratuar në janar 2015 nga Qeveria [...] parashihet organizmi i departamentit ligjor, prandaj, pa ndryshuar Katalogu, nuk mund të ndryshohet organizimi i departamentit ligjor dhe departamenteve të tjera”*.
20. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se Ligji i Shërbimit Civil përcakton mënyrën e krijimit të Marrëdhënies së Punës dhe sipas këtij Ligji parashtruesi i kërkesës ka aktemërim për pozitën e Drejtorit dhe nuk është e mundur që pa asnjë bazë ligjore t’i shuhet dhe fuzionohet ose ndryshohet vendi i punës.
21. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht shtyrjen e ekzekutimit të Rregullores nr. 14/2018, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata.
22. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të aprovojë kërkesën si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht Rregulloren nr. 14/2018, përkatësisht në lidhje me fuzionimin e Departamentit Ligjor si njërin nga divizionet brenda Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
24. Gjykata i referohet paragrafit 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”*.
25. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafëve 2 (1) dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë si në vijim:

“2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së [...] rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën”;

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara

me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Gjykata merr parasysh edhe rregullin 39 (1) (a) [Kriteret e pranueshmërisë], të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“1. Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

*(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar;
[...]*”

27. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij nuk konteston vendimet gjyqësore që janë zhvilluar në lidhje me rastin e tij ku ai kishte kontestuar ligjshmërinë e Rregullores nr. 14/2018. Ai para Gjykatës konteston, *in abstractio*, kushtetutshmërinë e Rregullores nr. 14/2018, duke pretenduar se kjo rregullore është në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjin për Administratë Shtetërore dhe Ligjin për Shërbimin Civil, si dhe në kundërshtim me aktet nënligjore të Qeverisë, dhe rrjedhimisht i rrezikon atij vendin e punës.
28. Megjithatë, Gjykata rikujton se Kushtetuta e Kosovës nuk ka paraparë mundësinë që një individ të kontestojë pajtueshmërinë e rregulloreve të Qeverisë. Këtë kompetencë Kushtetuta e ka paraparë për palët e autorizuara si: Kuvendin e Republikës së Kosovës, Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Avokatin e Popullit, të cilët mund t'i kontestojnë rregulloret e Qeverisë sipas nenit 113, paragrafi 2 (1) të Kushtetutës.
29. Përveç kësaj, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk parasheh *actio popularis*, që do t'i mundësonte çdo individ, që tenton të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me pyetje dhe me kërkesa të caktuara, duke aluduar se dispozitat e caktuara ligjore apo aktet publike janë në kundërshtim me Kushtetutën (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Centre for Legal Resources on Behalf of Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë*, nr. 47848/08, Aktgjykimi i 17 korrikut 2014, paragrafi 101).
30. Individët kanë të drejtë të kontestojnë vetëm aktet individuale të autoriteteve publike që cenojnë të drejtat e tyre individuale dhe vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike, të përcaktuara me paragrafin 7, të nenit 113 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI102/17, parashtrues: *Meleq Imeri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 janarit 2018, paragrafi 20).
31. Andaj, në kushtet kur kërkesa është parashtruar nga një palë e paautorizuar, Gjykata nuk mund të vlerësojë meritat e rastit dhe rrjedhimisht, as në rastin konkret, Gjykata nuk vlerëson pretendimet e parashtruesit të kërkesës nëse dispozitat e Rregullores nr. 14/2018 janë apo jo në përputhje me Kushtetutën.

32. Rrjedhimisht, nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është paraqitur në mënyrë ligjore nga një palë e autorizuar siç përcaktohet me nenin 113, paragrafi 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

33. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës, gjithashtu kërkon nga Gjykata që të nxjerr vendim për vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht shtyerjen e zbatimit të Rregullores nr. 14/2018 deri në vendosjen e rastit nga Gjykata.
34. Gjykata sapo konkludoi se kërkesa e parashtuesit nuk i përmbush kriteret procedurale të pranueshmërisë.
35. Prandaj, në pajtim me nenin 27, paragrafi 1 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 57, paragrafi 1 të Rregullores, kërkesa e parashtuesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit, përderisa kërkesa deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, të neneve 27 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, më 3 prill 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi